



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

JUDICIAL STRENGTHENING PROJECT

elsa


The European Law Students' Association
REPUBLIC OF MACEDONIA



ORGANIZIMI I SISTEMIT GJYQËSOR NË RM




- ***Sipas cilit parim mbështetet organizimi i pushtetit në Republikën e Maqedonisë?***



Në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, parimi i ndarjes së pushtetit është njëra prej vlerave bazike të sistemit tonë ligjor. Thelbi i këtij parimi, i sjellur në vitin 1991, është ai se pushteti është ndarë në atë legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Pushtetin legjislativ e kryen Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, bartës të pushtetit ekzekutiv janë Presidenti i Republikës së Maqedonisë dhe Qeveria e Republikës së Maqedonisë, kurse pushtetin gjyqësor e kryejnë gjykatat në Republikën e Maqedonisë. Thelbi i këtij parimi përbëhet në atë se ata duhet të jenë plotësisht të ndarë dhe të pavarur në punën e njëri tjetrit. Megjithatë, ekzistojnë mekanizma të caktuara për kontroll dhe mbikëqyrje, nëse njëra nga tre pushtetet e kryen funksionin e saj në mënyrë të jashtëligjshme .


● **Si është organizuar sistemi gjyqësor në vendin tonë?**



Në shtetin tonë, SECILI qytetar mund të realizojë të drejtën e vet përmes inicimit të procedurës para ndonjëres prej 27 **gjykatave themelore**. Pastaj, kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat të gjykatave themelore janë 4 **gjykatat e apelit** – në Shkup, Manastir, Shtip dhe Gostivar. Shkalla e tretë e mbrojtjes të të drejtave të qytetarëve realizohet para **Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë**.

Gjykata Administrative dhe Gjykata e Lartë Administrative janë gjykata të sapoformuara, të cilat kanë për detyrë të mbrojnë të drejtat e cenuara të qytetarëve nga organet shtetërore.


Gjykata Kushtetuese si institucion i pavarur dhe autonom nga sistemi gjyqësor, kontrollon nëse ligjet e miratuara dhe aktet tjera janë në përputhje me Kushtetutën, dhe i mbron liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit në lidhje me lirinë e mendimit, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimit, bashkimit dhe veprimit politik dhe ndalimit të diskriminimit në bazë të gjinisë, racës, përkatësisë fetare, kombëtare, sociale dhe politike.



Për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve, ekzistojnë llojet vijuese të procedurave para gjykatave në Republikën e Maqedonisë – **procedura penale, procedura civile dhe procedura për kontest administrativ**. Procedura gjyqësore civile përbëhet prej procedurës kontestimore dhe jashtëkontestimore. Ekzekutimi i vendimeve të përmbaarura gjyqësore me Ligjin për përmbarim të vitit 2005, është transferuar nga gjykatat tek përmbaruesit, si persona që kryejnë autorizime publike të përcaktuara me ligj.



Të drejtat që rrjedhin nga marrëdhëniet civile-ligjore personale, familjare, pronësore, të punës, tregtare dhe të tjera, mbrohen në **procedurën kontestimore civile**.





Procedura kontestimore parashtrohet me **padi** para gjykatës themelore. Padi do të parashtrrojë personi i cili konsideron se ndonjë e drejtë e tij është shkelur – *paditësi*. Procedura kontestimore parashtrohet kundër personit për të cilin pohohet se e ka kryer shkeljen – *i paditur*. Gjykata është kompetente për zgjidhjen e kontestit me miratimin e vendimit në formën e **aktgjykimit** ose **vendimit**, me çka përfundon procedura e shkallës së parë.



Nëse njëra nga palët nuk është e kënaqur me vendimin e miratuar të gjykatës, mund të parashtrrojë **ankesë** para gjykatës kompetente të apelit në afatin e përcaktuar. Ajo do ta rishqyrtojë lëndën dhe do të vendos – ose do ta konfirmon vendimin e shkallës së parë, ose lëndën do ta kthen për një vendim të sërishëm, ose vet do të vendos.



Kundër vendimit të gjykatës së apelit, pala e pakënaqur nën kushte saktësisht të përcaktuar me ligj, ka të drejtë të parashtron **revizion** para Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, e cila është gjykata e vetme kompetente për vendimmarrje në shkallën e tretë në Republikën e Maqedonisë. Vendimi, të cilin do ta miraton Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë, është përfundimtar.

Individët të cilit konsiderojnë se nga ana e shtetit u janë shkelur disa të drejta të njeriut të garantuara nga Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut dhe Protokollet, mund të kërkojnë mbrojtje me parashtrimin e aplikimit para Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut (Gjykata). Ky aplikim lejohet vetëm nëse janë shterur të gjitha të gjitha mjetet ligjore që janë në dispozicion në sistemin vendas ligjor, dhe nëse aplikimin Gjykata e merr në një afat prej 6 muajve nga miratimi i vendimit përfundimtar

DUA TË DI!

1. Procedura civile është publike. Kjo do të thotë se në këtë procedurë mund të marrin pjesë të gjithë personat e interesuar dhe numri i tyre nuk është i kufizuar. A ekzistojnë raste kur nuk lejohet prania e publikut?

- Ekzistojnë raste të caktuara për të cilat publiku gjithmonë është i përjashtuar me ligj. Të këtyra janë kontestet martesore dhe kontestet për përcaktimin e atësisë dhe amësisë, me qëllim që të mbrohen interesat personale të palëve. Gjykata me një vendim mund ta përjashtojë publikun në raste individuale nëse kjo është e nevojshme për ruajtjen e ndonjë sekreti zyrtar ose nëse konsideron se me praninë e publikut do të rrezikohet rendi publik dhe morali.

2. Të miturit a mund të kërkojnë mbrojtje para gjykatës?


- Të miturit mund t'i mbrojnë të drejtat e veta para gjykatës, por vetëm në mënyrë indirekte, përmes përfaqësuesve ligjor. Përfaqësues ligjor të miturve janë prindërit e tyre.

3. Cilat prova mund të përdoren në procedurën civile?

- Si prova në procedurën civile paraqiten: shqyrtimi, dokumentet, dëgjimi i dëshmitarëve, ekspertëve dhe i palëve.]

4. Gjykata a mund të iniciojë procedurë në bazë të detyrës zyrtare?

- Në procedurën civile gjykata nuk ka kompetenca të këtyra, procedurën e nxitë vetëm paditësi (nëse konsideron se ndonjë e drejtë e tij i është shkelur ose i është kufizuar) me parashtrimin e padisë para gjykatës.



5. Gjykatësit a gëzojnë imunitet në ushtrimin e funksionit gjyqësor?

- Gjykatësit gëzojnë imunitet vetëm në suazat e mendimit të shprehur ose të vendimmarrjes gjatë miratimit të vendimeve gjyqësore. Ata nuk mund të thirren në përgjegjësi për vendimin që do ta miratojnë. Nëse gjykatësi kryen veprë penale, do të përgjigjet për të njëjtën si secili qytetar i Republikës së Maqedonisë. Sipas Ligjit për gjykatat, gjykatësi nuk mund të arrestohet pa lejen e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, përveç nëse kapet në kryerjen e veprës penale për çka parashikohet dënimi me burg prej së paku 5 vjet.

6. Kush i zgjedh dhe i shkarkon gjykatësit

- Gjykatësit i zgjedh dhe i shkarkon Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë, si një organ autonom dhe i pavarur i gjyqësisë, i cili e siguron dhe garanton autonominë dhe pavarësinë e pushtetit gjyqësor.





Publikimi i kësaj broshure është rezultat i bashkëpunimit midis projektit të USAID për fuqizimin e gjyqësisë dhe Shoqatës evropiane të studentëve të juridikut



Kjo broshurë është botuar me ndihmën e agjencisë së SHBA-së për zhvillimin ndërkombëtar (USAID) Qëndrimet e shprehura në broshurë nuk i pasqyrojnë qëndrimet e USAID-it ose të qeverisë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës